



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.9524/2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale neni Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40, Statuti i Komunës neni 24, Rregullorja për Organizimin e Kompetencave dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale 01/Nr.7113/2012 e datës 31.10.2012 neni 4, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.12.2024 merr:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS
PËR VITIN 2025

1. Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025.
2. Plani i punës së kryetarit të komunës për vitin 2025 përmban aktivitete dhe objektivat e punës së ekzekutivit të komunës në bazë të ligjeve të aplikueshme dhe Statutit të Komunës.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:30.12.2024





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr. 9558/2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 11, 12 shkronja (d), 40, Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012-MPB-032012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi neni 9 paragrafi 1.7, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.12.2024 merr:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR
VITIN 2025

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2025.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2025 për komunën e Hanit të Elezit.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi,
- Ministria e Punëve të Brendshme,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.12.2024





01/Nr. 9557/2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 55, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.12.2024 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2025

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendimi njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komiteti për Komunitete,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30. 12. 2024





01/Nr.9525/2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 40, 68, Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna neni 6, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit me numër 01/Nr.4240/2023 neni 80, 81, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.12.2024 merr:

VENDIM

PËR DRAFT RREGULLORE KOMUNALE PËR MENAXHIMIN E PASURISË JOFINANCIARE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

1. Me këtë vendim aprovohet draft rregullorja komunale për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në Komunën e Hanit të Elezit.
2. Draft rregullorja komunale për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në Komunën e Hanit të Elezit lëshohet në procedurë të diskutimit publik me qytetarë.
3. Obligohet Drejtoria e Administratës së Përgjithshme dhe Drejtori për Buxhet dhe Financa procedurat e diskutimit publik me qytetarët dhe pas kësaj rezultatet e diskutimit publik t'i paraqesin në Kuvendin e Komunës për finalizimin e draft rregullores për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në Komunën e Hanit të Elezit.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është draft rregullorja komunale për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në Komunën e Hanit të Elezit.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorja e Administratës së Përgjithshme,
- Drejtoria e për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.12.2024





01/Nr.9543/2024

Bazuar në nenin 14 pika 3 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme, nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme, nenit 58 shkronja (h) si dhe nenit 12 pika 12.1, 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Statutin e Komunës neni 11, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.12.2024 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË VEÇANTË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS TË CILAT PLANIFIKOHEN TË JEPEN NË SHFRYTËZIM PËR VITIN 2025

1. Miratohet lista e veçantë e pronave të paluajtshme të Komunës Hani i Elezit të cilat planifikohen të jepet në shfrytëzim palëve të interesuara vitin 2025, si më poshtë vijon

Numri rendor	Numri i parcelës	Zona kadastrale	Vendi i quajtur	Sipërfaqja m ²	Kultura	Destinimi
1	73317070-00927-0	Pustenik	Nikona	11710	Arë e klasit 8	Bujqësi – Blektori
2	73317055-00963	Krivenik	Kodra Rojt	4038	Kullosë e klasit 6	Bujqësi – Blektori
3	73317070-00946-0	Pustenik	Tanask	8906	Kullosë e klasit 4	Bujqësi – Blektori
4	73317073-00792-0	Rezhancë	Ortica	19461	Kullosë e klasit 6	Bujqësi – Blektori
5	73317073-00789-1	Rezhancë	Gjuri	9510	Kullosë e klasit 5	Bujqësi – Blektori

2. Parcelat e lartshënuara do të jepet në shfrytëzim palëve të interesuara me qëllim të shfrytëzimit efektiv të pronës së paluajtshme të Komunës, zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik përmes nxitjes dhe zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë në vendbanimet rurale të Komunës .
3. Parcelat e lartshënuara janë të destinuara për zhvillim të aktiviteteve bujqësore: mbjelljet e kulturave të ndryshme bujqësore, aktiviteteve nga fusha e blegtorisë, shfrytëzim si kullosa, ngritje të minifermave dhe aktivitete të ngjashme.
4. Parcelat e lartshënuara do të jepet në shfrytëzim për një periudhë kohore afatgjatë që nënkupton periudhën kohore prej 15 vite deri 99 vite me një çmim fillestar 100 € për ha në vit dhe 0.20 € m² në vit për objektet ndërtimore si p.sh shtalla apo objekte përcjellëse.
5. Dhënia në shfrytëzim do të bëhet përmes ankandit publik sipas procedurave të përcaktuara me rregulloren (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe kombinimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

6. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë zyra ligjore e Kryetarit në bashkëpunim me drejtorinë e Urbanizmit, drejtorinë e Bujqësisë dhe stafin ndihmës të Komunës.
7. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtori për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 30.12.2022





01/Nr. 9549 /2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L-26 neni 11 paragrafi 11.2, Udhëzimin Administrativ Nr.10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 të datës 27.12.2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore neni 6, pika 6.3, dhe në bazë të kërkesës z.Faton Curri me numër 11/Nr.3901/2024, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.12.2024 merr:

V E N D I M
PËR NDËRRIM DESTINIM TË TOKËS BUJQËSORE

1. Kuvendi i komunës miratoi kërkesën e z.Faton Curri për ndërrim destinim të përhershëm të tokës bujqësore në atë ndërtimore.
2. Sipërfaqja e lejuar e tokës për ndërrim të destinimit është 210 m², e cila gjendet në vendin e quajtur "Fusha" zona kadastrale Dimcë, më kulturë Arë e klasit të pestë (5), e evidentuar në emër të z. Faton Curri, sipas certifikatës pronësore P-73317025-00451-7 e cila tani e tutje do të jetë pronë ndërtimore.
3. Parcela e lartë shënuar është në Planin Zhvillimor Komunal, andaj u vendos që destinimi i pronës me kulturë Arë e klasit të pestë (5), të bëhet parcelë ndërtimore.
4. Pronari i palujtshmërisë në emër dhe interes të të cilit bëhet ndërrim destinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore obligohet që pronën ta shfrytëzoj vetëm për qëllimin e caktuar.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në bazë të ligjeve në fuqi.
6. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Parashtruesi i Kërkesës,
- Drejtoria për Urbanizëm për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.12.2024





01/Nr. 9550 /2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L-26 neni 11 paragrafi 11.2, Udhëzimin Administrativ Nr.10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 të datës 27.12.2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore neni 6, pika 6.3, dhe në bazë të kërkesës z.Endrit Curri me numër 11/Nr.3900/2024, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.12.2024 merr:

V E N D I M
PËR NDËRRIM DESTINIM TË TOKËS BUJQËSORE

1. Kuvendi i komunës miratoi kërkesën e z.Endrit Curri për ndërrim destinim të përhershëm të tokës bujqësore në atë ndërtimore.
2. Sipërfaqja e lejuar e tokës për ndërrim të destinimit është 110 m², e cila gjendet në vendin e quajtur "Fusha" zona kadastrale Dimcë, më kulturë Arë e klasit të pestë (5), e evidentuar në emër të z. Endrit Curri, sipas certifikatës pronësore P-73317025-00451-6 e cila tani e tutje do të jetë pronë ndërtimore.
3. Parcela e lartë shënuar gjendet në Planin Zhvillimor Komunal andaj u vendos që destinomi i pronës që me kulturë Arë e klasit të pestë (5), të bëhet parcelë ndërtimore.
4. Pronari i palujtshmerisë në emër dhe interes të të cilit bëhet ndërrim destinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore obligohet që pronën ta shfrytëzoj vetëm për qëllimin e caktuar.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në bazë të ligjeve në fuqi.
6. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Parashtruesi i Kërkesës,
- Drejtoria për Urbanizëm për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.12.2024

